



Në mbështetje nenit 64.2 pika (a) dhe (b) dhe neneve 99, 100 dhe 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), dhe neneve 20, 25 dhe 29.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale (LZL) në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 09.03.2023, miraton këtë:

RREGULLORE NR. 09/2023
REGJISTRIMI DHE VOTIMI I PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Neni 1
Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton mënyrën e regjistrimit, evidentimit dhe votimit të personave me nevoja të veçanta (VPNV).
2. VPNV do të zbatohet në ditën e zgjedhjeve nga Komisioni i Votimit të Ekipit Lëvizës (KVEL), të organizuara nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ), në komunat e tyre.

Neni 2
Regjistrimi i votuesve me lëvizshmëri të kufizuar

1. Votuesit me lëvizshmëri të kufizuar konsiderohen votuesit me zotësi juridike që nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotim (VV), për shkak të paaftësisë fizike, shëndetësore ose çfarëdo paaftësie tjetër.
2. Votuesi me zotësi juridike i cili dëshiron të regjistrohet si votues i ngjuar në shtëpi, duhet të aplikojë për regjistrim përmes aplikacionit online ose të dorëzojë në KKZ përkatëse formularin për regjistrim, në periudhën kohore midis gjashtëdhjetë (60) ditë dhe pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së zgjedhjeve.
3. Me kërkesën për aplikim duhet të dërgohen së bashku edhe dokumentet, si më poshtë:
 - 3.1. formularin e plotësuar të bashkangjitur, Formulari për regjistrimin e votuesve me nevoja të veçanta - shtojca I;
 - 3.2. kopje të dokumentit të identifikimit (letënjoftim i vlefshëm, dokument i udhëtimit i vlefshëm, pasaportë e vlefshme);

- 3.3. një fotokopje të certifikatës së paaftësisë, diagnozës mjekësore ose dëshmi tjetër relevante në mbështetje të aplikimit të tij/saj.
4. Organizatat joqeveritare (OJQ) të cilat janë të regjistruara dhe të specializuara për ndihmën e personave të ngjuar në shtëpi, mund të pranojnë formularë për regjistrim dhe t'i paraqesin në KKZ, të plotësuar me emrat e personave për t'u përfshirë në programin e votuesve të personave të ngjuar në shtëpi.
 5. Formularët për regjistrim mund të merren në zyret e KKZ dhe në ueb faqen e KQZ.
 6. KKZ, brenda dy (2) ditëve nga parashtrimi i kërkesës, do t'i shqyrtojë të gjitha aplikacionet, duke i krahasuar me kriteret e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe do t'i informojë me shkrim, përmes aplikacionit apo përmes telefonit, të gjithë aplikuesit nëse u janë pranuar ose refuzuar aplikacionet e tyre.
 7. KKZ informon aplikuesit të cilëve u janë refuzuar kërkesat dhe se, ata mund të votojnë personalisht në vendvotimin e caktuar, ose të kërkojnë korrigjim ligjor brenda afatit të dhënë në njoftim, në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje.
 8. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, KKZ:
 - 8.1. Përpilon listën e të gjithë votuesve të ngjuar në shtëpi, të regjistruar të asaj komunë, me këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal të letërnjoftimit, adresën e shtëpisë të secilit votues të ngjuar në shtëpi dhe numrin e telefonit;
 - 8.2. dorëzon një kopje elektronike të këtyre votuesve të regjistruar në KQZ;
 - 8.3. bën ndarjen e listës sipas adresave, në atë mënyrë që votuesit nga një zonë e njëjtë gjeografike të vizitohen nga i njëjti KVEL.

Neni 3

Regjistrimi i votuesve në institucione

1. Votuesit në institucione, konsiderohen votuesit me zotësi juridike me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion, si: votuesit në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, votuesit me aftësi të zvogëluar mentale në institucionet e kujdesit shëndetësor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendra të paraburgimit.
2. KQZ përmes memorandumeve të bashkëpunimit me institucione relevante bën të mundur evidentimin e këtyre votuesve.

3. KKZ identifikon institucionet e përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni brenda komunës së vet. KKZ në bashkëpunim me administratën e institucioneve, bën evidentimin e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote në këto institucione, jo më vonë se 8 ditë para ditës së zgjedhjeve. Kjo evidencë duhet të përfshijë këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal të letërnjoftimit, gjininë dhe numrin e telefonit, nëse e ka.
4. KKZ duhet të dërgojë një listë të këtyre qytetarëve në KQZ, jo më vonë se një ditë pas përfundimit të periudhës së evidentimit. KQZ përgatit fletëvotimet dhe materialet tjera në bazë të të dhënave të votuesve sipas komunës e origjinës.
5. Në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave, për të votuar në njërin nga institucionet e përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, votuesi me zotësi juridike duhet të jetë i regjistruar në institucionet e lartpërmendura, më së voni në ditën e tetë (8) para ditës së zgjedhjeve.

Neni 4

Regjistrimi i votuesve në rrethana të veçanta

1. Votuesit në rrethana të veçanta konsiderohen votuesit me zotësi juridike që jetojnë në bashkësitë, që për shkak të zhvendosjes nga vendi afër vendvotimit të tyre të rregullt ose për shkaqe sigurie nuk mund të votojnë në vendvotimin e tyre të caktuar. Për këtë lloj votimi kërkohet miratimi nga KKZ.
2. Votuesit në rrethana të veçanta mund të regjistrohen përmes aplikacionit ose përmes kërkesës në KKZ.
3. KKZ përgatisin paraprakisht listën me të dhënat e votuesve dhe lokacionet ku ndodhen/jetojnë votuesit në rrethana të veçanta, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së zgjedhjeve. Të dhënat duhet të përfshijnë: emrin, mbiemrin, datëlindjen, numrin personal të letërnjoftimit, adresën e banimit dhe numrin e telefonit.

Neni 5

Shënjimi i votuesve të regjistruar në listën përfundimtare të votuesve

KKZ, jo më vonë se një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve, i shënjon (vulosë) në listën përfundimtare të votuesve dhe bën të qartë që votuesi nuk mund të votojë në vendvotim.

Neni 6

Përbërja dhe përgjegjësitë e KVEL

1. KVEL përbëhet nga një kryesues dhe dy anëtarë.
2. KKZ do të vendosë numrin e KVEL të nevojshëm për të udhëhequr procesin e votimit të votuesve të ngjuar në shtëpi, votuesit në institucione dhe votuesit në rrethana të veçanta.

3. KKZ do t'i informojë paraprakisht vëzhguesit e akredituar për drejtimet nga do të shkojnë KVEL dhe me orarin e planifikuar, për t'u mundësuar vëzhguesve që t'i shoqërojnë ata në vizitat e tyre te votuesit e ngujur në shtëpi, votuesit në institucione dhe votuesit në rrethana të veçanta.
4. Çdo ekip i votimit të personave me nevoja të veçanta do të ketë një libër të votimit, në të cilin do të shënohen të dhënat e rëndësishme përkitazi me zhvillimin e votimit të personave me nevoja dhe rrethana të veçanta - VPNRV.
5. Procesi i votimit i votuesve të personave të ngujur në shtëpi, institucione dhe atyre në rrethana të veçanta, zhvillohet prej orës 09:00 deri 19:00.
6. Të gjithë anëtarët e KVEL do të votojnë në VV e tyre të rregullt, para orës 09:00 në ditën e zgjedhjeve.

Neni 7

Ndarja e fletëvotimeve për votuesit e ngujur në shtëpi, votuesit në institucione dhe votuesit me rrethana të veçanta

1. Në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, KKZ do të bëjnë ndarjen e fletëvotimeve për votuesit e ngujur në shtëpi, votuesit në institucione dhe votuesit me rrethana të veçanta, nga paketimet rezervë të fletëvotimeve për komunat e tyre.
2. Në zgjedhjet lokale, KQZ do të bëjë ndarjen e fletëvotimeve nga paketimet e fletëvotimeve të shtypura për tri kategoritë e votuesve me nevoja të veçanta.
 - 2.1. Fletëvotimet ndahen për votuesit me zotësi juridike, sic përcaktohen në nenin 3 paragrafi 1 të kësaj Rregulloreje;
 - 2.2. në rast se në listën e votuesve të personave të ngujur në shtëpi, në institucione dhe atyre në rrethana të veçanta identifikohen nga KKZ si votues të komunave tjera, ndërsa janë banorë të komunës ku paraqitet kërkesa, për zgjedhjet lokale KQZ pajisë KKZ me fletëvotime të komunës ku votuesi është në listën përfundimtare të votuesve - LPV.

Neni 8

Procesi i votimit

1. KKZ bëjnë përgatitjet e nevojshme për votim, si dhe të informojnë administratën e institucioneve përkatëse për planin dhe orarin e ekipit për votim në institucione.
2. KVEL zbaton procedurat e njëjta për votimin siç përcaktohet me nenin 15 të Rregullores nr. 12/2023 të KQZ.
3. Para nisjes, duke u parë qartë nga KKZ dhe çdo vëzhgues i akredituar i pranishëm, KVEL:

- 3.1. Mbyll kutinë e fletëvotimeve dhe shënon numrin e shiritit mbyllës të sigurisë në formularin e përputhjes – FPVPNRV – shtojca II, të bashkangjitur;
 - 3.2. merr nga KKZ pakon e lidhur me nga 50 fletëvotime për secilën palë zgjedhje dhe shkruan në FPVPNRV përkatëse numrin e gjithmbarshëm të fletëvotimeve të pranuar;
 - 3.3. merr nga KKZ listën e votuesve të ngujuar në shtëpi, votuesve në institucione dhe në rrethana të veçanta, e cila do të përfshijë të dhënat sipas nenit 2 paragrafi 8 nënparagrafi 8.1., nenit 3 paragrafi 3 dhe nenit 4 paragrafi 3 të kësaj Rregulloreje.
4. KVEL, te çdo votues/e, para procesit të votimit, kryen veprimet si në vijim:
 - 4.1. Tregojë distinktivët identifikues të dhënë dhe të vulosur nga KKZ, gjatë gjithë kohës sa zgjatë procesi;
 - 4.2. kërkon nga votuesi që të identifikohet, duke përdorur një dokument identifikimi të pranueshëm;
 - 4.3. pasi që votusi të jetë nënshkruar në listën e votuesve KVEL shënon të dhënat e votuesit në zarfet e fletëvotimeve, pastaj do t'i jepet fletëvotimi(et) dhe do të udhëzohet për procedurat e votimit, duke garantuar fshehtësinë e votës;
 - 4.4. ia mundëson çdo personi të pranishëm që t'i ndihmojë votuesit për të votuar, por jo anëtar i KVEL e as vëzhguesi i akredituar;
 - 4.5. i jep votuesit një fletëvotim tjetër, nëse ai/ajo e ka dëmtuar fletëvotimin e parë, ruan fletëvotimin e dëmtuar dhe e regjistron si “i dëmtuar”;
 - 4.6. siguron që, pas plotësimit të fletëvotimit(eve), votuesi të fus fletëvotimin(et) në zarfin(at) e fshehtësisë, të mbyllet zarfi(at) i fshehtësisë dhe futet brenda zarfit të fletëvotimeve me ZFK. Pas mbylljes së ZFK, votuesi do ta vendosë atë në kutinë e votimit nën vëzhgimin vëzhguesve.
 5. Nëse KVEL identifikon se votuesi nuk gjendet në adresën e vendbanimit ose votuesi refuzon të votojë, shënon në librin e votimit dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KVEL.
 6. Numërimi i fletëvotimeve për të tri kategoritë e votuesve me nevoja dhe rrethana të veçanta do të bëhet në të njëjtën mënyrë si numërimi e fletëvotimeve siç është e përcaktuar me nenin 5 të Rregullores nr. 14/2023 QNR.
 7. Në fund të procesit KVEL duhet të mbyllë vrimën e kutisë së votimit dhe t'i dërgojë të gjitha materialet në KKZ, ku nën mbikëqyrjen e KKZ dhe të vëzhguesve të pranishëm, do t'i numërojë fletëvotimet e papërdorura dhe të dëmtuara.

Neni 9
E drejta e ankesës

1. Çdo votues i regjistruar si votues me nevoja të veçanta në KKZ, si rezultat i ndryshimit të rrethanave të caktuara, mund të kërkojë nga KKZ të rikthehet si votues i rregullt në vendvotim, por jo më vonë se pesë (5) ditë para ditës së zgjedhjeve.
2. KKZ duhet të njoftojë me shkrim çdo votues me zotësi juridike të cilit i është mohuar kërkesa për VPNRV, jo më vonë se dy (2) ditë pas parashtrimit të kërkesës, duke e informuar për të drejtën e tij/saj për të kërkuar korrigjim ligjor në gjykatën e shkallës së parë, në pajtim me LZP.
3. Nëse gjykata e shkallës së parë mbrenda tre (3) ditëve nga pranimi i ankesës, vendos se votuesi ka të drejtë të marrë pjesë në programin e VPNRV, urdhëron KQZ ta inkuadrojë votuesin në listën e VPNRV.

Neni 10
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla zgjedhore Nr.04/2013 votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta.
2. Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore është:

Shtojca I - Formulari për regjistrimin e votuesve me nevoja të veçanta;
shtojca II - formularin e përputhjes – FPVPNRV.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi